

VENDIM
Nr. 21, datë 28.4.2021

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vitore Tusha	kryetare e Gjykatës Kushtetuese
Elsa Toska	anëtare e “ “
Marsida Xhaferllari	anëtare e “ “
Altin Binaj	anëtar i “ “
Përparim Kalo	anëtar i “ “
Sonila Bejtja	anëtare e “ “
Fiona Papajorgji	anëtare e “ “

me sekretare Enina Ktoni, në datat 15.4.2021, 21.4.2021 dhe 28.4.2021 mori në shqyrtim në seancë plenare publike çështjen nr. S (5) 2019 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë, përfaqësuar nga avokatët Edisa Theodhori dhe Genc Çifligu, me prokurë të posaçme.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Merita Qato, me autorizim.

Këshilli i Ministrave, Përfaqësuar nga Elira Kokona dhe Embro Ahmetaj, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi i nenit 19, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Pezullimi i zbatimit të nenit 19, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, deri në hyrjen në fuqi të vendimit të Gjykatës Kushtetuese.

BAZA LIGJORE: Nenet 11, 17, 18, 41, 59, 134, pika 1, shkronja “h” dhe pika 2, 154, 155 dhe 157 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 1 i Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ); nenet 27, 45, 49, pika 3, shkronja “d” dhe 50, pika 1, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Fiona Papajorgji, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuases, Shoqatës së Ndërtuesve të Shqipërisë (*Shoqata e Ndërtuesve*), që kërkoj pranimin e kërkesës, parashtrimet e subjekteve të interesuara, Kuvendit të Republikës së Shqipërisë (*Kuvendi*) dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë (*Këshilli i Ministrave*), që kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kuvendi i Shqipërisë, me propozimin e Këshillit të Ministrave, ka miratuar ligjin nr. 22/2018, “Për strehimin social” (ligji nr. 22/2018). Ky ligj është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 79, në datën 30 maj 2018 dhe ka hyrë në fuqi në datën 14 qershor 2018.

2. Neni 19, pika 1, i ligjit nr. 22/2018, parashikon se çdo subjekt privat që, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, aplikon për leje zhvillimi dhe ndërtimi për ndërtime me sipërfaqe ndërtimore banimi mbi 2.000 m², siguron kalimin pa shpërblim e të paktën 3% të sipërfaqes funksionale, me kushtet e një strehimi të përshtatshëm, në favor të fondit publik të banesave sociale. Kjo sipërfaqe, në rast pamundësie për t'u dhënë në sipërfaqen ndërtimore të banimit që ndërtohet, mund të jepet në një sipërfaqe tjetër ndërtimore banimi. Kontrata që nënshkruhet mes palëve për kalimin e sipërfaqes ndërtimore në favor të fondit publik të banesave sociale, regjistrohet në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

3. Në pikën 2 të të njëjtit nen përcaktohet se nëse një subjekt që aplikon për leje zhvillimore për ndërtim banese, për efekt përfitimi, kërkon rritje të intensitetit të ndërtimit, në përputhje me standardet e miratuara në planin vendor dhe vetëm atëherë kur bashkia ka miratuar një plan vendor, atij mund t'i akordohet shtesa në intensitet përkundrejt përfitimit të një sipërfaqeje ndërtimi në favor të bashkisë për strehim social, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

4. Shoqata e Ndërtuesve, përfaqësuar nga zoti Artan Dulaku, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) në datën 2.7.2019, duke kërkuar shfuqizimin e nenit 19, të ligjit nr. 22/2018, si të papajtueshëm me Kushtetutën dhe njëkohësisht pezullimin e zbatimit të këtij neni, deri në hyrjen në fuqi të vendimit të Gjykatës.

5. Me plotësimin e kuorumit për funksionimin e kolegjeve seleksionuese të Gjykatës, në datën 21.1.2020 është vendosur kalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare publike. Gjithashtu, me përmbushjen e parashikimit të kërkuar nga neni 32, pika 1, i ligjit nr. 8577/2000, për shqyrtimin e çështjeve në seancë plenare, u bë e mundur marrja në shqyrtim e kësaj çështjeje.

III

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

6. Kërkesja, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtuar se dispozita e kundërshtuar cenon këto të drejta dhe liri kushtetuese:

6.1 *Lirinë e veprimtarisë ekonomike*, të parashikuar në nenin 11, pika 3, të Kushtetutës, pasi shoqëritë e ndërtimit detyrohen të paguajnë një detyrim financiar me një ligj që nuk ka si qëllim specifik vendosjen e detyrimeve financiare. Kjo dispozitë është bërë në kundërshtim me kërkesat e nenit 17 të Kushtetutës, pasi nuk ekziston asnjë arsye publike dhe nuk respekton parimin e proporcionalitetit të ndërhyrjes.

6.2 *Të drejtën e pronës private*, të parashikuar në nenin 41 të Kushtetutës, pasi me dispozitën e kundërshtuar janë parashikuar procedura shpronësimi *de facto*, pa asnjë lloj kundërshtimi, në kundërshtim me rregullat kushtetuese për kufizimin e kësaj të drejte.

6.3 *Parimin e barazisë përpara ligjit*, të parashikuar në nenin 18 të Kushtetutës, pasi dispozita e kundërshtuar diskriminon drejtpërdrejt subjektet ndërtuese në raport jo vetëm me subjektet juridike në fusha të tjera, por edhe mes vetë shoqërive të ndërtimit.

6.4 *Të drejtën e konsultimit publik*, pasi shoqëritë e ndërtimit nuk janë konsultuar për metodologjinë e përdorur në hartimin e këtij detyrimi ligjor.

6.5 *Nenet 155 dhe 157 të Kushtetutës*, lidhur me detyrimet kushtetuese për tatimet, taksat dhe detyrimet financiare, pasi dispozita objekt kërkesë, u ka vendosur shoqërive të ndërtimit një detyrim shtesë që nuk është e natyrës fiskale.

6.6 Zbatimi i dispozitës së kundërshtuar sjell pasoja të rënda dhe të pariparueshme, jo vetëm për shoqëritë e ndërtimit, por edhe për konsumatorët, ndaj Gjykata duhet të vendosë pezullimin e zbatimit të saj deri në dhënien e vendimit përfundimtar.

7. Subjekti i interesuar, Kuvendi i Shqipërisë, ka paraqitur, në mënyrë të përmbledhur, këto prapësime:

7.1 Kërkuesja nuk legjitimohet *ratione personae* në paraqitjen e kërkesës, pasi nuk ka argumentuar në asnjë moment se cili është interesi i saj i drejtpërdrejtë dhe vetjak që preket nga dispozita e kundërshtuar dhe në çfarë mënyre ligji nr. 22/2018, i cili nuk ka në objekt të tij shoqëritë e ndërtimit, por subjektet zhvilluese, cenon të drejtat dhe interesat e subjekteve që janë anëtarë të saj.

7.2 Dispozita nuk cenon *lirinë e veprimtarisë ekonomike*, pasi kjo liri nënkupton edhe detyrimin e shtetit që, nëpërmjet legjislacionit, të ndërhyjë në rregullimin e saj, me qëllim që të garantohet parimi i shtetit social dhe i së mirës së përbashkët. Pranohen si kufizime të arsyeshme të lirisë së veprimtarisë ekonomike nismat e ligjvënësit, të cilat shërbejnë për një rregullim të tregut ose interesave të një shteti social.

7.3 Nuk cenohet *e drejta e pronës*, pasi dispozita e kundërshtuar nuk synon në asnjë pjesë të saj shpronësimin e shoqërive që marrin leje për zhvillimin e një prone. Gjithashtu, dispozita nuk u mohon shoqërive ndërtuese ushtrimin e së drejtës së gëzimit dhe të disponimit të objektit që ata do të ndërtojnë. Ajo parashikon vetëm dhënien e një kontributi në mbështetje të shtresave në nevojë.

7.4 Nuk cenohet *parimi i barazisë përpara ligjit*, pasi dispozita e kundërshtuar i trajton në mënyrë të njëjtë të gjitha shoqëritë e ndërtimit që ndodhen në kushte të njëjta. Shoqëritë që veprojnë në fushën e ndërtimit nuk mund të pretendojnë të trajtohen në mënyrë të njëjtë me shoqëritë që ushtrojnë veprimtarinë në fusha të tjera.

7.5 Për sa i përket cenimit të neneve 155 dhe 157 të Kushtetutës, kontributi që japin shoqëritë e ndërtimit, në bazë të dispozitës objekt gjykimi, nuk mund të konsiderohet si tatim ose taksë. Ai është një kontribut që sektori privat jep në fondin e banesave sociale nëpërmjet kalimit të një sipërfaqeje të caktuar ndërtimore në favor të sistemeve të strehimit social.

7.6 Në lidhje me pretendimin për *mungesën e konsultimit publik*, në procesin e diskutimit të ligjit nr. 22/2018, ligjvënësi ka organizuar disa seanca dëgjimore me përfaqësues të institucioneve, organizatave të shoqërisë civile dhe grupeve të interesit, duke shteruar kështu edhe konsultimin publik përpara miratimit të këtij akti.

7.7 Kërkesa për pezullimin e zbatimit të dispozitës së kundërshtuar nuk është e bazuar, sepse në asnjë moment ajo nuk krijon premisa për cenim të interesit publik.

8. **Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave**, ka paraqitur në mënyrë të përmbledhur, këto prapësime:

8.1 Kërkuesja legjitimohet pjesërisht *ratione materiae* dhe *ratione personae*, pasi ka ngritur pretendime të cilat nuk i përkasin interesit të saj të ligjshëm vetjak dhe të drejtpërdrejtë, si dhe bien jashtë fushës së veprimit të dispozitës objekt shqyrtimi nga Gjykata. Kërkuesja përfaqëson interesat e ndërtuesve dhe jo ato të zhvilluesve, në emër të të cilëve del leja e ndërtimit dhe ndaj të cilëve zbatohet dispozita e kundërshtuar.

8.2 Pretendimi për cenimin e *lirisë së veprimtarisë ekonomike* është i pabazuar, pasi nëpërmjet kësaj dispozite shteti vendos një rregull për ushtrimin e veprimtarisë ekonomike në sektorin e ndërtimit, duke garantuar parimet e shtetit social. Qëllimi i kësaj ndërhyrjeje është përmbushja e objektivit social, në kuptim të nenit 59 të Kushtetutës, për plotësimin e nevojave për strehim të qytetarëve, të cilët nuk kanë mundësi të përballojnë strehimin.

8.3 Dispozita e kundërshtuar nuk cenon *të drejtën e pronës private*, pasi nuk kemi të bëjmë me një aset ekzistues, i cili shoqërohet me një sërë të drejtash, si e drejta e gëzimit, tjetërsimit ose shpronësimit.

8.4 Nuk cenohet as parimi i *barazisë përpara ligjit*, pasi ky detyrim i është vendosur kësaj kategorie subjektesh për arsye të specifikave të objektit të veprimtarisë së tyre, çka i vendos ato në kushte objektivisht të ndryshme.

8.5 I pabazuar është edhe pretendimi se neni 19 i ligjit nr. 22/2018 bie në kundërshtim me nenet 155 dhe 157 të Kushtetutës. Ndërhyrja konkrete vendos një detyrim në formë kontributi, i cili nuk dëmton thelbin e aktivitetit dhe nuk bën të pamundur ushtrimin e tij.

8.6 Lidhur me pretendimin për cenimin e *së drejtës së konsultimit publik*, në procesin e hartimit të këtij ligji janë respektuar edhe dispozitat e ligjore për konsultimin publik, duke përdorur një ndër mjetet e komunikimit, atë të afishimit në faqen zyrtare të internetit.

8.7 Kërkuesja nuk justifikon dëmin potencial që mund t'u vijë anëtarëve të shoqatës, subjekteve që operojnë në fushën e ndërtimit. Zbatimi i dispozitës objekt kërkesë nuk sjell pasoja që prekin interesa shtetërore, shoqërore ose të individëve, për pasojë nuk ndodhemi në kushtet e nenit 45, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për kërkesën për pezullimin e zbatimit të nenit 19 të ligjit nr. 22/2018

9. Kërkuesja ka kërkuar pezullimin e zbatimit të nenit 19 të ligjit nr. 22/2018, duke argumentuar se zbatimi i tij sjell pasoja të rënda dhe të pariparueshme jo vetëm për shoqëritë e ndërtimit, por edhe për konsumatorët, pasi ky detyrim i vendosur nga dispozita e kundërshtuar do të sjellë rritje të çmimit për metër katror. Në mbështetje të këtij pretendimi, kërkuesja ka paraqitur vendimin nr. 105, datë 25.10.2019 të Këshillit Bashkiak Tiranë.

10. Subjektet e interesuara, Kuvendi i Shqipërisë dhe Këshilli i Ministrave, kanë prapësuar se zbatimi i dispozitës objekt kërkesë nuk sjell pasoja që prekin interesa shtetërore, shoqërore ose të individëve dhe në asnjë moment ky ligj nuk krijon premisa për cenim të interesit publik. Për rrjedhojë, nuk ndodhemi në kushtet e nenit 45, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000.

11. Sipas nenit 45, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, të ndryshuar, Gjykata, kryesisht ose me kërkesë të palëve, kur vlerëson se zbatimi i ligjit ose aktit mund të sjellë pasoja që prekin interesa shtetërore, shoqërore ose të individëve, sipas rastit, me vendim të Mbledhjes së Gjyqtarëve ose në seancë plenare urdhëron pezullimin e tij. Sipas kësaj dispozite, së pari: subjekti që kërkon pezullimin e një akti duhet të provojë preken e interesave shtetërore, shoqërore ose të individëve, si dhe pasojat e pariparueshme që do të sjellë zbatimi i aktit; së dyti: shqyrtimi i kërkesës mund të bëhet nga Gjykata përpara ose në seancë plenare.

12. Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, në datën 13.1.2021, pasi mori në shqyrtim parashtrimet e palëve për këtë kërkim, vlerësoi se në rastin konkret nuk përmbushen kriteret ligjore lidhur me mundësinë e cenimit të interesave shtetërore, shoqërore ose të individëve nga zbatimi i këtij ligji dhe në çdo rast pasojat nga zbatimi i dispozitës objekt kërkesë nuk janë të menjëhershme. Për këto arsye, Mbledhja e Gjyqtarëve vendosi rrëzimin e kërkesës për pezullimin e zbatimit të nenit 19 të ligjit nr. 22/2018, objekt kërkesë.

B. Për legjitimitimin e kërkuar

13. Çështjen e legjitimitimit (*locus standi*) Gjykata e ka vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhen me vënien në lëvizje të një procesi kushtetues. Në gjykime të kontrollit të kushtetutshmërisë së normës, subjektet që parashikohen në nenin 134, pika 2, të Kushtetutës kanë detyrimin për të provuar lidhjen e domosdoshme që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë ligjore që ato kryejnë dhe çështjes kushtetuese të ngritur (*shih vendimin nr. 4, datë 15.2.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Kërkuesja, në momentin që ka vënë në lëvizje Gjykatën, ka parashtruar se legjitimohet për të vënë në lëvizje juridiksionin kushtetues, në kuptim të nenit 134, pika 1, shkronja "h" dhe pika 2, të Kushtetutës, pasi është një organizatë e regjistruar si person juridik në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe, sipas aktit të themelimit dhe nenit 5 të statutit të saj, ajo "*...ka për qëllim mbrojtjen dhe përfaqësimin e interesave dhe të drejtave të shoqërive të ndërtimit, shoqërive të prodhimit të materialeve të ndërtimit, shoqërive të projektimit dhe instalimeve në fushën e ndërtimit, personave juridik ose fizik të regjistruar, si dhe mbrojtjen e mjedisit urban... Këto qëllime shoqata i realizon nëpërmjet këtyre rrugëve: ... f) reagimi me mjete ligjore ndaj akteve që shkelin të drejtat kushtetuese dhe ligjore të anëtarëve të shoqatës*". Sipas saj, të drejtat e anëtarëve, në rastin konkret cenohen nga neni 19 i ligjit nr. 22/2018, prandaj dhe interesi i saj për kundërshtimin është i justifikuar.

15. Në seancën plenare të datës 15.4.2021, gjatë parashtrimit të kërkesave paraprahe, subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, ka kërkuar verifikimin e legjitimitetit të kryetarit të Shoqatës së Ndërtuesve, zotit Artan Dulaku, i cili ka nënshkruar prokurën për përfaqësimin e saj në gjykimin kushtetues, pretendim ky që nuk është ngritur në prapësimet me shkrim të depozituara prej tij. Sipas Këshillit të Ministrave, zotit Artan Dulaku i ka përfunduar mandati si kryetar i shoqatës që në vitin 2007 dhe ai nuk është riemëruar rishtazi në këtë cilësi, gjë e cila pasqyrohet edhe në vërtetimin e datës 14.4.2021, të lëshuar nga registri i organizatave jofitimprurëse, që për këtë qëllim u depozitua në seancë.

16. Gjykata vëren se nga aktet bashkëlidhur kërkesës në shqyrtim rezulton se me prokurën nr. 806 rep., nr. 328 kol., datë 21.6.2019 zoti Artan Dulaku, në cilësinë e përfaqësuesit të shoqatës, ka autorizuar shoqërinë “Master Legal” sh.p.k. (ish-“G.A.T-Legal Consulting” sh.p.k.) që nëpërmjet avokatëve të saj të përfaqësojnë Shoqatën e Ndërtuesve në këtë gjykim kushtetues. Në bazë të kësaj prokure është paraqitur kërkesa në datën 2.7.2019 (e cila është nënshkruar edhe nga zoti Artan Dulaku, në cilësinë e përfaqësuesit të Shoqatës së Ndërtuesve) është vijuar me përfaqësimin e kërkuësës në seancat plenare të zhvilluara në Gjykatën Kushtetuese.

17. Përfaqësuesi ligjor i Shoqatës së Ndërtuesve në lidhje me mungesën e legjitimitetit të përfaqësimit të kryetarit të saj, po në të njëjtën seancë, argumentoi se zoti Artan Dulaku përfaqëson ligjërisht Shoqatën e Ndërtuesve dhe se kjo e fundit, për të mbështetur sa më sipër, mund të paraqesë edhe akte të brendshme që e provojnë këtë argument.

18. Në seancën e datës 21.4.2021, pas afatit kohor që iu la në dispozicion kërkuësës nga kjo Gjykatë për të paraqitur dokumentacionin e duhur në lidhje me legjitimitetin e përfaqësuesit të saj, zotit Artan Dulaku, përfaqësuesi ligjor i saj nuk depozitoi prova të reja, por parashtrori se bashkëlidhur kërkesës është paraqitur edhe dokumentacioni provues në lidhje me legjitimitetin e përfaqësimit të kryetarit të shoqatës. Sipas tij, Shoqata e Ndërtuesve është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë në vitin 2001, me kryetar zotin Artan Dulaku, i cili, sipas nenit 26 të statutit, gëzon të drejtat e përfaqësimit të shoqatës në raport me palët e treta, duke pasur kështu edhe tagrat e autorizimit të përfaqësimit të shoqatës. Gjithashtu, përfaqësuesi ligjor i kërkuësës argumentoi se zoti Artan Dulaku vazhdon të ushtrijë funksionin e kryetarit të Shoqatës së Ndërtuesve dhe ka të gjitha kompetencat e këtij organi drejtues, pasi nuk ka asnjë vendim për përfundimin e mandatit të tij. Në mbështetje të këtij pretendimi ai ka paraqitur edhe disa memorandume bashkëpunimi ndërmjet Shoqatës së Ndërtuesve dhe disa institucioneve shtetërore, ku shoqata ka qenë e përfaqësuar nga zoti Artan Dulaku, në cilësinë e kryetarit të saj, i cili edhe i ka nënshkruar ato.

19. Për sa i përket legjitimitetit të shoqatave, si subjekte që vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, sipas nenit 134, pika 1, shkronja “h”, të Kushtetutës, Gjykata ka tashmë një jurisprudencë të konsoliduar, e cila ka pranuar legjitimitetin e këtyre subjekteve për çështje që lidhen me interesat e tyre. Ajo është shprehur se organizata që vë në lëvizje Gjykatën duhet të provojë se në çfarë mënyre ajo mund të preket në një aspekt të veprimtarisë së saj, pra duhet të provojë lidhjen e drejtpërdrejtë dhe të individualizuar që ekziston midis veprimtarisë së saj dhe normës që kundërshton. Interesi për të vepruar duhet të jetë i sigurt, i drejtpërdrejtë dhe vetjak. Ky interes konsiston tek e drejta e shkelur, te dëmi real ose potencial dhe jo te premiset teorike për antikushtetutshmërinë e normës që ka sjellë këtë cenim të interesit. Në këtë drejtim është e nevojshme të provohet se dispozita e kundërshtuar rregullon marrëdhënie që përfshihen në qëllimin e veprimtarisë së kërkuësës, sipas përcaktimeve të bëra në Kushtetutë, në ligje ose, në rastin e subjekteve të së drejtës private, në statut (*shih vendimet nr. 4, datë 15.2.2021, nr. 1, datë 16.1.2017; nr. 33, datë 8.6.2016; nr. 14, datë 21.3.2014, të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Në rastin në shqyrtim, nisur nga rëndësia thelbësore që merr garantimi i së drejtës së aksesit në gjykatë, në drejtim të administrimit të drejtësisë dhe sigurimit të të gjitha aspekteve të një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes, pra jo vetëm në kuptim të së drejtës për të filluar një proces, por edhe të së drejtës për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt të kontrollit kushtetues, Gjykata vlerëson të analizojë fillimisht, kërkesën paraprahe të

subjektit të interesuar, Këshillit të Ministrave, lidhur me legjitimimin e përfaqësimit të kryetarit të shoqatës, duke qenë se lidhet drejtpërdrejt me aksesin në gjykim të saj.

21. Në këtë drejtim, për sa i përket përfaqësimit të shoqatave në gjykimin kushtetues, Gjykata vlerëson të nevojshme t'i referohet përmbajtjes së dispozitave të Kodit Civil (KC), i cili parashikon se personi juridik mund të kryejë çdo veprim juridik të lejuar në ligj, në aktin e krijimit ose në statut dhe se ai vepron me anë të organeve të veta të parashikuara në ligj, në aktin e krijimit ose në statut, të cilat shprehin vullnetin e tij. Veprimet juridike të kryera nga organet e personit juridik, brenda kompetencave të tyre, quhen si të kryera nga vetë personi juridik (nenet 30– 31).

22. Në rastin në shqyrtim kërkesja është person juridik i regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. 38, datë 12.10.2001. Thënë ndryshe, ajo është organizim i disa individëve që veprojnë në mbrojtje të interesave të tyre të përbashkëta dhe funksionon e vepron si e tillë nëpërmjet organeve të saj drejtuese e vendimmarrëse, që sipas nenit 10 të statutit të saj janë mbledhja e përgjithshme, bordi drejtues, kryetari i bordit. Kjo do të thotë se shprehja e vullnetit të anëtarëve të kërkeses, për kryerjen e veprimeve juridike si person juridik, realizohet nëpërmjet këtyre organeve, të cilat në ushtrimin e kompetencave të tyre duhet të veprojnë brenda tagrave të dhëna nga anëtarët themelues të personit juridik. Vetëm në këtë mënyrë veprimet që kryejnë këto organe cilësohen si veprime që kryhen nga vetë shoqata.

23. Për sa u përket kufijve të përfaqësimit, KC-ja ka parashikuar se tagrat e përfaqësimit ligjor përcaktohen nga dispozitat e ligjit që parashikojnë përfaqësimin, ndërsa tagrat e përfaqësuesit të emëruar nga i përfaqësuari disponohen me prokurë (neni 65). Veprimet juridike të kryera nga përfaqësuesi, brenda tagrave që i janë dhënë atij, sjellin pasoja dhe krijojnë efekte juridike drejtpërdrejt për të përfaqësuarin dhe përfaqësuesi nuk mund të kryejë veprime juridike në emër të të përfaqësuarit as me veten e tij, as me persona të tjerë të përfaqësuar prej tij, përveçse kur i përfaqësuari e ka lejuar këtë shprehimisht, ose kur përmbajtja e veprimit juridik nuk cenon interesat e tij (nenet 66- 67). Kur një person fizik ose juridik vepron si përfaqësues pa e pasur këtë cilësi, si edhe kur përfaqësuesi ka vepruar përtej tagrave që i janë dhënë, veprimi juridik i kryer në këto kushte nuk është i detyrueshëm për personin në emrin e të cilit janë kryer, përveç kur ky e ka miratuar atë më vonë (neni 78).

24. Për sa më sipër, veprimet e kryera nga organet drejtuese të personit juridik, që të jenë të vlefshme edhe të prodhojnë pasoja dhe efekte juridike për anëtarët e saj edhe ndaj të tretëve, duhet të jenë kryer brenda kufijve të përfaqësimit të përcaktuara nga këto organe.

25. Në kushtet kur KC-ja i ka dhënë të drejtën e lirisë së organizimit vetë shoqatës, Gjykata, për verifikimin e legjitimitetit të autorizimit të saj për paraqitjen e kërkesës objekt gjykimi, u referohet normave të statutit të kërkeses. Sipas këtij, të fundit organet drejtuese të shoqatës janë mbledhja e përgjithshme, bordi drejtues, kryetari i bordit (neni 10). Mbledhja e përgjithshme zgjedh çdo tre vjet bordin drejtues (neni 11). Bordi drejtues është organ ekzekutiv i shoqatës (neni 18). Kryesia e bordit ka një mandat për tre vjet, por dhe mund të rizgjidhet (neni 25). Kryetari i bordit përfaqëson shoqatën në marrëdhëniet me palët e treta (neni 26).

26. Bazuar në parashikimet e mësipërme të statutit të kërkeses, Gjykata vëren se mandati i kryetarit të shoqatës është tre vjet, me të drejtë rizgjedhjeje. Ndërkohë, në asnjë dispozitë të statutit nuk është parashikuar rizgjedhja ose zgjatja e mandatit të kryetarit të shoqatës në mënyrë të heshtur. Në rastin konkret zoti Artan Dulaku është zgjedhur si kryetar i shoqatës në vitin 2001, kur kjo shoqatë është krijuar dhe është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Më pas Shoqata e Ndërtuesve ka depozituar disa vendime në regjistrin e organizatave jofitimprurëse, ku vendimi i fundit i përket datës 5.10.2004. Pas kësaj date asnjë vendim i shoqatës nuk rezulton të jetë depozituar dhe regjistruar në regjistrin e organizatave jofitimprurëse, edhe pse vetë shoqata vazhdon të ekzistojë si person juridik. Edhe vetë kërkesja në seancë nuk paraqiti asnjë dokument që të mund të provonte zgjatjen ose rinovimin e mandatit të kryetarit të saj.

27. Gjithashtu, për të arritur në një përfundim të bazuar në vlerësimin objektiv të kësaj situate, Gjykata, pasi shtyu seancën, e cila u njoftua publikisht, i dha kërkeses kohën e mjaftueshme për të

paraqitur prova shkresore për të provuar para saj cilësinë e zotit Artan Dulaku si person me tagra përfaqësimi të shoqatës kërkuese në këtë gjykim kushtetues. Pavarësisht kësaj, përfaqësuesi ligjor i Shoqatës së Ndërtuesve nuk paraqiti asnjë akt ose vendim me anë të të cilit të provohej miratimi i tagrave të përfaqësimit të zotit Artan Dulaku nga organet drejtuese të shoqatës, pra për të vërtetuar në këtë mënyrë se inicimi i këtij gjykimi kushtetues është shprehje e vullnetit të anëtarëve të kërkueses dhe rezultat i diskutimeve, si dhe i vendimmarrjes së tyre. Edhe gjatë seancës së datës 21.4.2021 përfaqësuesi ligjor i kërkueses, i pyetur shprehimisht për këtë situatë, u përgjigj, se: “*ndoshta shoqata për konflikte që mund të ketë anëtarësia, nuk ka arritur dot kuorumin e nevojshëm që të mbledhet e të zgjedhë anëtarët e bordit ... ndoshta mosmarrëveshjet që mund të kenë pasur anëtarët e shoqatës apo shkaqe të tjera kanë bërë të pamundur ushtrimin e kompetencave të Mbledhjes së Përgjithshme të anëtarëve të saj, për të zgjedhur bordin drejtues dhe ndërmjet tyre edhe kryetarin e bordit*” (shih procesverbalin e datës 21.4.2021).

28. Për më tepër, Gjykata konstaton se Shoqata e Ndërtuesve e ka vënë edhe më parë në lëvizje atë për kontrollin e pajtueshmërisë me Kushtetutën të normave ligjore (*shih vendimet nr. 16, datë 26.2.2008; nr. 17, datë 31.3.2008, të Gjykatë Kushtetuese*). Gjykata, bazuar në aktet e administruara në dosjet gjyqësore që u përkasin këtyre çështjeve, konstaton se aktet e përfaqësimit dhe kërkesat janë nënshkruar nga zoti L.A., në cilësinë e kryetarit të shoqatës, duke u bazuar në vendimin e bordit drejtues të shoqatës të datës 31 mars 2007 (vendim i depozituar në ato gjykime). Për rrjedhojë, nuk rezulton që mandati i zotit Artan Dulaku si kryetar i shoqatës të ketë vijuar nga fillimi i ushtrimit të tij në vitin 2001 deri në momentin e shqyrtimit të kësaj çështjeje, pasi jo vetëm që nuk u paraqitën vendime të bordit drejtues për riemërimin e tij në këtë detyrë sipas rregullave statutores, por, përkundrazi, me vendim të bordit drejtues mandati është ndërprerë në vitin 2007 për zgjedhjen e zotit L.A., i cili, në kuptim të nenit 26 të statutit, ka përfaqësuar shoqatën në marrëdhëniet me të tretët.

29. Në vijim të analizës së mësipërme, Gjykata vëren se Shoqata e Ndërtuesve vijon të ushtrojë veprimtarinë e saj si person juridik dhe ka zotësinë për të dhënë autorizime ose nënshkruar akte për përfaqësimin e saj në marrëdhënie me të tretët. Ndërkohë vërehet se për një hark të gjatë kohor, duke nisur nga viti 2007 (data e vendimit të bordit drejtues që ka zgjedhur kryetarin e ri), deri në momentin e shqyrtimit të kësaj çështjeje, nuk është kryer asnjë veprim tjetër juridik në drejtim të zgjedhjes së kryetarit të saj.

30. Si përfundim, në kushtet kur gjatë gjykimit nuk u provua zgjedhja e zotit Artan Dulaku si kryetar i shoqatës pas vendimit të fundit të vitit 2007 të bordit drejtues të shoqatës, si dhe nuk u materializua në asnjë moment vullneti i shprehur i anëtarëve të shoqatës kërkuese për të iniciuar këtë gjykim kushtetues nëpërmjet zotit Artan Dulaku si përfaqësues i saj, Gjykata konstaton mungesën e legjitimitetit të përfaqësimit të kërkueses nga zoti Artan Dulaku në Gjykatën Kushtetuese.

31. Gjithashtu, Gjykata vlerëson se ky arsyetim nuk paragjykon të drejtën e aksesit në gjykimin kushtetues, në të ardhmen, të anëtarëve të shoqatës, nëse ata zgjedhin t'i drejtohen asaj duke ushtruar ankim kushtetues individual, në përputhje me kriteret kushtetuese dhe ligjore, sipas nenit 131, pika 1, shkronja “f”, nenit 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe nenit 49 të ligjit nr. 8577/2000.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “a” dhe 134, pika 1, shkronja “h” dhe pika 2, të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 28.4.2021.

Shpallur më 26.5.2021.

Kryetar kundër: Vitore Tusha

Anëtarë: Marsida Xhaferllari, Elsa Toska, Përparim Kalo, Altin Binaj, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja

MENDIM PAKICE

1. Në kushtet kur nuk jam dakord me vendimin e shumicës në çështjen me kërkuese Shoqatën e Ndërtuesve të Shqipërisë, me objekt shfuqizimin e nenit 19 të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, si të pajtueshëm me Kushtetutën, paraqes në vijim argumentet e mia që mbështesin qëndrimin në pakicë.

2. Shumica, në përfundim të gjykimit në lidhje me këtë çështje, ka vendosur rrëzimin e kërkesës, duke arsyetuar, se: “... në kushtet kur gjatë gjykimit nuk u provua zgjedhja e zotit Artan Dulaku si kryetar i shoqatës pas vendimit të fundit të vitit 2007 të bordit drejtues të shoqatës, si dhe nuk u materializua në asnjë moment vullneti i shprehur i anëtarëve të shoqatës kërkuese për të iniciuar këtë gjykim kushtetues nëpërmjet zotit Artan Dulaku si përfaqësues i saj, Gjykata konstaton mungesën e legjitimitetit të përfaqësimit të kërkueses nga zoti Artan Dulaku në Gjykatën Kushtetuese” (pika 30 e vendimit).

3. Në vlerësimin tim, bazuar në rrethanat konkrete të kësaj çështjeje, si dhe në parashikimet ligjore që duhej të gjenin zbatim në këtë rast, Gjykata duhej të kishte vendosur pushimin e gjykimit të çështjes dhe jo rrëzimin e saj.

4. Në kreun VII, të ligjit nr. 8577/2000, që rregullon procedurat e veçanta të gjykimit kushtetues, janë parashikuar rregullat procedurale për rastet e shqyrtimit të pajtueshmërisë së ligjeve ose të akteve të tjera normative me Kushtetutën dhe me marrëveshjet ndërkombëtare. Sipas nenit 51/a të këtij kreu (shtuar me ligjin nr. 99/2016) “1. Gjykata Kushtetuese pas shqyrtimit të çështjes vendos: a) rrëzimin e kërkesës; b) pranimin tërësisht ose pjesërisht të kërkesës dhe shfuqizimin e ligjit ose aktit normativ. 2. Në çdo rast Gjykata Kushtetuese në dispozitivin e vendimit shprehet edhe për efektin e vendimit dhe pasojat e tij.”. Këto dispozita në mënyrë të qartë i referohen shqyrtimit të themelit të çështjes nga ana e Gjykatës, çka do të thotë se janë të zbatueshme vetëm në ato raste kur Gjykata shprehet në lidhje me bazueshmërinë e pretendimeve të ngritura në kërkesë. Po ashtu, rrëzimi i kërkesës vendoset edhe në ato raste kur kërkuesi nuk arrin të provojë legjitimitetin në kuptimin substancial të tij, pra interesin e drejtpërdrejtë, cenimin dhe pasojat e ardhura ose dëmin e shkaktuar këtij subjekti, por jo në rastet kur vihet në dyshim legjitimiteti formal i përfaqësuesit të kërkuetit për sa u takon akteve të përfaqësimit dhe tagrave të tij.

5. Gjykata ka vendosur edhe në raste të tjera pushimin e gjykimit të çështjes pas shqyrtimit të saj në seancë plenare, kur kërkuesi ka hequr dorë nga kërkesa ose kur ajo ka mbetur pa objekt. Me vendimin nr. 9, datë 19.3.2008, Gjykata, gjatë fazës së diskutimit të çështjes, konstatoi se pika 1 e nenit 23 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” ishte ndryshuar nga ligjvënësi dhe këto ndryshime kishin hyrë në fuqi. E ndodhur para një fakti të tillë, Gjykata arriti në përfundimin se nuk mund të shprehej për pretendimet lidhur me pajtueshmërinë e kësaj dispozite me Kushtetutën, pasi në momentin e vendimmarrjes ajo nuk ekzistonte më, pasi ishte ndryshuar tërësisht. Në këto kushte, Gjykata vendosi pushimin e shqyrtimit gjyqësor të kërkesës në lidhje me këtë dispozitë.

6. Në të njëjtën linjë Gjykata ka vendosur pushimin e çështjes edhe me vendimet: nr. 4, datë 12.2.2010, me objekt ligjin nr. 9831, datë 12.11.2007, “Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist”, pasi konstatoi se gjatë shqyrtimit të çështjes, ligjvënësi kishte miratuar disa ndryshime ligjore që u jepnin përgjigje pretendimeve të kërkueses; nr. 23, datë 16.4.2014, me objekt

aktin normativ të Këshillit të Ministrave nr. 6, datë 4.10.2013, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 119/2012, “Për buxhetin e vitit 2013” dhe ligjin miratues të tij nr. 166/2013, datë 24.10.2013, pasi vlerësoi se këto akte i kishin përfunduar efektet e tyre në fund të vitit 2013 dhe se ligji i ri në fuqi nuk ishte bërë objekt kërkesë përpara kësaj Gjykate; nr. 57, datë 5.12.2014, me objekt VKM-në nr. 354, datë 4.6.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për ngritjen e bazës së të dhënave IMEI për regjistrimin e numrave IMEI të aparateve celulare, që përdoren në rrjetet e shërbimeve të komunikimeve të lëvizshme”, pasi konstatoi se Këshilli i Ministrave kishte shfuqizuar aktin objekt kërkesë, për rrjedhojë VKM-ja objekt shqyrtimi i kishte përfunduar efektet e saj dhe çështja kishte mbetur pa objekt.

7. Shumica, duke analizuar kriteret e legjitimitetit të shoqatës si subjekt i kushtëzuar kushtetues (pika 19 e vendimit), ka vlerësuar ekzistencën e Shoqatës së Ndërtuesve të Shqipërisë si person juridik (pika 22 e vendimit). Në vijim, ajo ka vendosur ta rrëzojë kërkesën për mungesë të legjitimitetit të përfaqësuesve të shoqatës në këtë gjykim kushtetues, por pa arsyetuar në lidhje me legjitimitetin substancial të kërkuësës, pra të ekzistencës së interesit të saj për të vënë në lëvizje gjykimin kushtetues, çka do të ishte shkak për rrëzimin e saj.

8. Paraprakisht vlerësoj se verifikimi i akteve të përfaqësimit është një çështje që i përket fazës së shqyrtimit administrativ dhe asaj paraprak së kërkesës, ku palët kanë detyrimin të paraqesin edhe aktet e përfaqësimit, sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, me pasojë kthimin e kërkesës për plotësim ose moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, në kuptim të nenit 31 të këtij ligji. Ndërkohë që shqyrtimi i këtyre elementeve në seancë plenare merr një tjetër natyrë dhe rëndësi në gjykimin kushtetues. Për shkak të rëndësisë së këtij lloji gjykimi, me ndryshimet që ligjvënësi i ka bërë ligjit nr. 8577/2000 me ligjin nr. 99/2016, ka parashikuar edhe vazhdimin e gjykimit në rastet e heqjes dorë nga kërkesa kur vlerëson se ajo paraqet interes publik (pika 2 e nenit 31/b) ose vazhdimin e gjykimit për interes publik edhe në rast se akti normativ ose pjesë të tij shfuqizohen ose ndryshohen para se Gjykata Kushtetuese të marrë vendim (pika 2 e nenit 51). Në këtë mënyrë ligjvënësi ka parashikuar edhe tejkalimin e vullnetit të subjektit që e ka vënë në lëvizje Gjykatën, kur ai është shprehur qartë në lidhje me tërheqjen nga gjykimi, e lidhur ngushtësisht me disponimin e tij për kërkesën, pasi prevalon interesi publik në shqyrtimin e çështjes, duke vijuar me gjykimin e saj.

9. Në rastin konkret, Gjykata nuk mori asnjë masë që të njoftonte vetë kërkuësen dhe t’i kërkonte asaj, ose të merrte pjesë në gjykim për të provuar interesin e saj, ose të paraqiste akte në mbështetje të sa u vu në diskutim në këtë gjykim nga subjektet e interesuara, edhe pse i dha mundësinë përfaqësuesit ligjor të paraqiste akte që të provonte se zoti Artan Dulaku është përfaqësuesi ligjor i shoqatës. Siç shprehet edhe shumica: “... *veprimet e kryera nga organet drejtuese të personit juridik, që të jenë të vlefshme edhe të prodhojnë pasoja dhe efekte juridike për anëtarët e saj dhe ndaj të tretëve, duhet të jenë kryer brenda kufijve të përfaqësimit të përcaktuara nga këto organe*” (pika 24 e vendimit).

10. Në këtë drejtim, shumica në vendimin e saj shprehet, se: “*gjithashtu, për të arritur në një përfundim të bazuar në vlerësimin objektiv të kësaj situatë, Gjykata, pasi shtyu seancën, e cila u njoftua publikisht, i dha kërkuësës kohën e mjaftueshme për të paraqitur prova shkrese për të provuar para saj cilësinë e zotit Artan Dulaku si person me tagra përfaqësimi të shoqatës kërkuëse në këtë gjykim kushtetues. Pavarësisht kësaj, përfaqësuesi ligjor i Shoqatës së Ndërtuesve nuk paraqiti asnjë akt ose vendim me anë të të cilit të provojë miratimi i tagrave të përfaqësimit të zotit Artan Dulaku nga organet drejtuese të shoqatës, pra për të vërtetuar në këtë mënyrë se inicimi i këtij gjykimi kushtetues është shprehje e vullnetit të anëtarëve të kërkuësës dhe rezultat i diskutimeve, si dhe i vendimmarrjes së tyre. Edhe gjatë seancës së datës 21.4.2021 përfaqësuesi ligjor i kërkuësës, i pyetur shprehimisht për këtë situatë, u përgjigj se ‘ndoshta shoqata për konflikte që mund të ketë anëtarësia, nuk ka arritur dot kuorumin e nevojshëm që të mbledhet e të zgjedhë anëtarët e bordit ... ndoshta mosmarrëveshjet që mund të kenë pasur anëtarët e shoqatës apo shkaqe të tjera kanë bërë të pamundur ushtrimin e kompetencave të Mbledhjes së Përgjithshme të anëtarëve të saj, për të zgjedhur bordin drejtues dhe ndërmjet tyre edhe kryetarin e bordit’” (pika 27 e vendimit). Në këto kushte, për sa kohë që vihej në diskutim legjitimiteti dhe pasja e tagrave pikërisht nga zoti Artan Dulaku, i cili ka nënshkruar kërkesën dhe, për rrjedhojë, edhe nga avokatët e zgjedhur prej tij, Gjykata krahas kërkesës për prova nga këta shtetas, duhej të kishte njoftuar vetë shoqatën ose të*

kërkonte edhe thirrjen e saj nëpërmjet organeve të saj përfaqësuese, në mënyrë që të materializohej vullneti i shprehur i anëtarëve të shoqatës kërkuese për të iniciuar këtë gjykim kushtetues.

11. Nga sa më sipër, në vlerësimin tim, Gjykata duhej të vendoste pushimin e gjykimit të kësaj çështjeje. Ndërkohë, duke u vendosur rrëzimi i kërkesës dëmtohen të drejtat e një subjekti, vullneti i të cilit për të vënë në lëvizje gjykimin kushtetues është konsideruar se nuk është shprehur qartë. Kjo mungesë e vullnetit, siç është konstatuar nga shumica, nuk mund të jetë shkak për rrëzimin e kërkesës, për sa kohë që mungesa e këtij vullneti nënkupton mungesën e kërkesës kushtetuese, pra të objektit të gjykimit kushtetues, që duhet të passjellë pushimin e këtij gjykimi.

12. Nga ana tjetër, duke u nisur nga diskrecioni që ka Gjykata për të vlerësuar vijimin e shqyrtimit mbi baza të interesit publik, si në rastin e heqjes dorë nga kërkesa, ashtu edhe në rast se kërkesa mbetet pa objekt, si dhe në kushtet kur kemi të bëjmë me një proces të zhvilluar në themel, i cili është përmbyllur me të gjitha elementet e tij, në seancë plenare publike, duhej të ishte vijuar me shqyrtimin e thelbit të pretendimeve dhe t'u jepej përgjigje atyre në lidhje me pajtueshmërinë e dispozitës së kundërshtuar me Kushtetutën.

Kryetar: Vitore Tusha